



KOMPANIA KOSOVARE PËR DISTRIBUIM DHE FURNIZIM ME ENERGIJE ELEKTRIKE S.H.A.  
KOSOVO ELECTRICITY DISTRIBUTION AND SUPPLY COMPANY J.S.C.  
KOSOVSKO PREDUZEĆE ZA DISTRIBUCIJU I SNABEVAJNE ELEKTRIČNOM ENERGIJOM D.O.

**KEDS - SH.A.**

Nr. 108 Dt. 28.12.2021  
HQ 1

**Ymer Fejzullahu**  
Kryesues i Bordit të ZRrE-së

**Alpin Dogan**  
Kryeshef Ekzekutiv  
KEDS sh.a

**28 dhjetor 2021**

**Lënda: Aplikim për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të të Hyrave të Lejuara Maksimale për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes**

I nderuar z. Fejzullahu,

Përmes kësaj shkrese, ju dërgojmë Aplikimin për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të të Hyrave të Lejuara Maksimale i cili është përgatitur sipas Rregullës për të Hyrat e OSSh-së dhe njoftimit të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRrE) për hapjen e procesit të shqyrtimit të jashtëzakonshëm, datë 13 dhjetor 2021.

Për shkak të rëndësisë së madhe të këtij procesi, OSSh-ja është e gatshme për bashkëpunim me qëllim që arrihet deri tek një zgjidhje e përbashkët për të gjitha palët pjesëmarrëse në sektorin e energjisë.

Me respekt

Alpin Dogan<sup>1</sup>

Kryeshef Ekzekutiv





Ndërtesa e Elektrokosovës    *Elektrokosova Building*  
Bulevardi Bill Clinton nr.3    *Bill Clinton Boulevard no.3*  
Prishtinë 10000    *Prishtina 10 000*  
Republika e Kosovës    *Republic of Kosovo*



# Aplikim për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të të Hyrave të Lejuara Maksimale

---

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes

Dhjetor, 2021



Ndërtesa e Elektrokosovës    *Elektrokosova Building*  
Bulevardi Bill Clinton nr.3    *Bill Clinton Boulevard no.3*  
Prishtinë 10000    *Prishtina 10 000*  
Republika e Kosovës    *Republic of Kosovo*



**Përmbajtja:**

1. Hyrje.....	3
2. Ndikimi financiar i çmimeve të energjisë elektrike .....	4
3. Kërkesa për të hyrat e lejuara maksimale për vitin 2022 .....	6



Ndërtesa e Elektrokosovës  
Bulevardi Bill Klinton nr.3  
Prishtinë 10000  
Republika e Kosovës

Elektrokosova Building  
Bill Clinton Boulevard no.3  
Prishtina 10 000  
Republic of Kosovo



## 1. Hyrje

Operator i Sistemit të Shpërndarjes ka përgatitur aplikimin për shqyrtim të jashtëzakonshëm për të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR), në përputhje me Rregullën për të Hyrat e Lejuara Maksimale të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (Rregulla për të hyrat e OSSH-së), dhe njoftimin e Zyres së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të datës 13 dhjetor 2021 për hapje të procesit për shqyrtim të jashtëzakonshëm.

Rritja e çmimeve të energjisë elektrike duke filluar nga muaji korrik 2021 ka përfshirë të gjitha vendet e Evropës, duke afektuar edhe sistemin elektroenergetik të Kosovës. Zyra e Rregullatorit të Energjisë me vendim nr. V\_1423\_2021 të datës 07.10.2021 ka aprovuar të Hyrat e Lejuara Maksimale për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes për vitin 2021 në vlerën prej 90,513,266 €, të cilat rezultuan me zbritje të tarifës së shpërndarjes për mesatarisht 12.5%.

Marrë parasysh zbritjen e tarifave për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes në këtë periudhë, ndërkohë që çmimet e importit janë jashtëzakonisht të larta krahasuar me çmimet e aprovuara nga ZRRE-ja gjatë shqyrtimit të të hyrave të lejuara maksimale në muajin tetor 2021. Për kundër kërkesave të drejta të OSSH-së për reflektimin e saktë të kostove, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes u vu në pozitë shumë të vështirë financiare, duke ia pamundësuar sigurimin e të hyrave të nevojshme kundrejtë kostove të paflektuara dhe të nevojshme për të mbuluar shpenzimet e tij.

I përballur me një situatë ku rritja e konsumit ka tejkaluar parashikimet e ZRRE-së që janë përdorur gjatë shqyrtimit për të hyrat e lejuara të OSSH-së dhe gjithashtu çmimet e importit kanë shënuar rritje enorme krahasuar me çmimet e lejuara nga ZRRE, KEDS ngriti shqetësimet e veta me ZRRE-në dhe Ministrinë e Ekonomisë si për menaxhimin e ngarkesës ashtu edhe për situatën e rënduar financiare duke kërkuar masa konkrete dhe veprime të menjëhershme, me qëllim të evitimit të një situatë ku pamundësohet operimi i qëndrueshëm i OSSH-së, por të cilat nuk dhanë efektet e dëshiruara. Prandaj, sipas të drejtës së dhënë përmes legjislacionit në fuqi dhe duke marrë parasysh kushtet e jashtëzakonshme të krijuara në mbarë botën lidhur me rritjen e shpejtë të çmimeve të energjisë elektrike, OSSH-ja kërkoi nga ZRRE që të shqyrtojë kërkesën e parashtruar për shqyrtim të jashtëzakonshëm me datë 15 nëntor 2021, si mjet i fundit për të mbrojtur të licencuarin nga situata e krijuar.

Në vijim të dokumentit, OSSH-ja ka paraqitur gjendjen aktuale dhe kërkesën e nevojshme me qëllim të reflektimit të saktë të kostove të nevojshme për të siguruar qëndrueshmëri të operimeve të OSSH-së. Çdo ndryshim nga kërkesa e paraqitur dhe argumentuar në vijim rrezikon seriozishtë operimet e OSSH-së. Procesi për shqyrtim të jashtëzakonshëm i hapur nga Rregullatori së fundmi është i vonuar, dhe përveç që ka kohë deri në përcaktimin e tarifave, e njëjta nuk ofron zgjidhje likuiditeti, andaj mos-reflektimi i saktë i kostove të nevojshme duke reflektuar drejtë rritjen tarifore të OSSH-së rrezikojnë sistemin elektroenergetik në vend.



## 2. Ndikimi financiar i çmimeve të energjisë elektrike

Në sistemet e energjisë, humbjet i referohen ndryshimit ndërmjet energjisë elektrike që hyn në sistem dhe energjisë së shpërndarë tek konsumatorët fundor dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, është përgjegjës për blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes.

Kostot e përgjithshme të humbjeve të lejuara për OSSH-në për vitin 2021 janë 952.7 MWh ose 50.9 milion €, ndërsa të dhënat aktuale për vitin 2021 tregojnë se OSSH-ja ka blerë 1,019 MWh humbje të lejuara me një kosto prej 87.5 milion €, pra për 7% rritje në volume OSSH-ja ka paguar 72% më shumë kosto, pa përfshirë edhe humbjet e tejkaluara për të cilat OSSH bart vet barrën financiare. Është e rëndësishme të sqarohet se Rregullatori gjatë përcaktimit të të hyrave të lejuara maksimale ka përdorur të dhënat aktuale për muaj janar-korrik, përkatësisht krahasimi i kostove paraqet ndryshimet vetëm për muajt gusht-dhjetor.

Të hyrat e realizuara nga OSSH-ja për vitin 2021 janë 104.9 milion €, ndërsa kostoja totale e realizuar arrin 121.8 milion €, pra OSSH ka bart barrën financiare për rreth 18.2 milion € (pa përfshirë kostot për humbjet e tejkaluara), që paraqet 20.10% të MAR-it të lejuar, ashtu siç është paraqitur në tabelën vijuese:

OSSH MAR 2021	Aprovuar 2021	Aktuale 2021
OPEX	25.53	25.53
DEPC	16.21	16.21
RTN	15.94	15.94
Humbjet	50.88	87.54
OT&OST	1.30	1.12
Të hyrat e parregulluara	(3.50)	(8.64)
Përshtatjet PR1	(1.50)	(1.50)
Taksa për Licence	0.10	0.10
KREV	(14.44)	(14.44)
<b>MAR</b>	<b>90.51</b>	<b>121.85</b>
Shitjet		104.90
KREV		18.19
Ndikimi		20%

Sidoqoftë, ndikimi financiar dhe kosto që mbart OSSH-ja nuk përfundon në dhjetor, por e njëjta vazhdon deri në mars të vitit 2022, kur pritet të bëhet rishikimi i kostove gjatë përcaktimit të vitit të ardhshëm tarifor.

Parashikimet e OSSH-së për blerjen e humbjeve të lejuara sipas draft bilancit për vitin 2022 vetëm për 3 mujorin e parë të vitit 2022 janë 94.4 milion €, me një çmim mesatar të importit të parashikuar prej 440.6 €/MWh, sipas parashikimeve të tregut hungarez për tremujorin e parë të vitit 2022, ndërsa të hyrat e



pritshme për tremujorin e parë të vitit 2022 janë 31.1 milion €. Respektivisht, ndikimi i KREV për vitin 2021 dhe kostot e pritshme për tremujorin e parë të vitit 2022 tregojnë një kosto prej 112.6 milion euro, me një përqindje të pambulueshmërisë prej 72%, siç është paraqitur në tabelën vijuese:

Humbjet e lejuara	15.10%
EED e pritshme	2,077
Mesatarja e çmimit	301.06
Kostot e humbjeve	<b>94,409</b>
KREV 2021	18,195
<b>Kostoja për OSSH-në</b>	<b>112,604</b>
Të hyrat e pritshme Jan-Mars 2022	31,096
Pambulueshmëria	81,508
Pambulueshmëria në %	72%

Nëse marrim parasysh edhe kostot tjera për 3 muajt e parë të vitit 2022, konform kostove të përcaktuara për vitin 2022 në periudhën e dytë rregulative, kostot e parashikuara të OSSH-së arrijnë vlerën prej 108.9 milion €. Respektivisht, marrë parasysh edhe ndikimin e KREV për vitin 2021, kostot totale të OSSH-së për periudhën janar-mars arrijnë vlerën prej 127.05 milion €, me një përqindje të pambulueshmërisë prej 76%, siç është paraqitur në tabelën vijuese:

OSSH MAR Jan-Mars 2022	Milion €
OPEX	6.42
DEPC	4.47
RTN	4.18
Humbjet	94.41
OT&OST	0.57
Të hyrat e parregulluara	(0.88)
Përshtatjet PR1	(0.38)
Taksa për Licence	0.06
KREV	18.19
<b>MAR</b>	<b>127.05</b>
Të hyrat e pritshme Jan-Mars 2022	31.10
Pambulueshmëria	95.96
Pambulueshmëria në %	76%

Prandaj, sipas të drejtës së dhënë përmes legjislacionit në fuqi dhe duke marrë parasysh kushtet e jashtëzakonshme të krijuara në mbarë botën lidhur me rritjen e madhe të çmimeve të energjisë elektrike



dhe me qëllim të ruajtje së stabilitetit financiar, OSSH-ja kërkon nga ZRRE që të aprovoj kërkesat e drejta dhe të arsyeshme të OSSH-së brenda periudhës së përcaktuar si më lartë. Në të kundërtën, shpërndarja e kostove në afate më të gjata nuk paraqet zgjidhje konkrete dhe e njëjta duhet të merr për bazë të gjitha kostot e pritshme për vitin 2022.

### 3. Kërkesa për të hyrat e lejuara maksimale për vitin 2022

Kriza globale e energjisë elektrike e përhapur gjatë vitit 2021, pritet të vazhdoj edhe përgjatë vitit 2022 sipas parashikimeve të çmimeve të importit në tregjet ndërkombëtare, të cilat janë pasqyruar në tabelën vijuese:

€/MWh	Çmimi jashtë pikut	Çmimi i pikut
Q1 2022	384.19	492.20
Q2 2022	253.49	305.46
Q3 2022	251.82	308.84
Q4 2022	270.50	338.64

Prandaj, OSSH-ja ka vlerësuar kostot e nevojshme për vitin 2022, marrë për bazë prodhimin e pritshëm sipas draft bilancit të vitit 2022 dhe pritshmërisë reale të energjisë në hyrje të sistemit të shpërndarjes. Energjia e pritur në nivel të shpërndarjes për vitin 2022 është 6,594 GWh, ndërsa kostot e pritshme për humbjet e lejuara janë 225.4 milion €, me një çmim mesatar prej 226.3 €/MWh.

<b>Humbjet e lejuara</b>	<b>15.10%</b>
EED e pritshme në GWh	6,594
Mesatarja e çmimit	226.3
<b>Kostoja e humbjeve</b>	<b>225.4</b>

Duke marrë në konsiderat kostot tjera të lejuara sipas Rregullës për të Hyrat e OSSH-së, konform kostove të përcaktuara për vitin 2022 në periudhën e dytë rregullative, kostot e parashikuara të OSSH-së për vitin 2022 arrijnë vlerën prej 300.5 milion €, siç është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

OSSH MAR 2022	Milion €
OPEX	25.69
DEPC	17.89
RTN	16.71
Humbjet	225.35
OT&OST	1.52
Të hyrat e parregulluara	(3.50)



Përshtatjet PR1	(1.50)
Taksa për Licence	0.17
KREV	18.19
<b>MAR</b>	<b>300.53</b>

Kërkesa e MAR-it për vitin 2022 është 232% më i lartë se MAR-i i aprovuar i vitit 2021. Të hyrat e pritshme me tarifatat aktuale janë 102.6 milion €, respektivisht kemi një pambulueshmëri prej 197.93 milion € apo 66% të kostove të pritshme.

Është e rëndësishme të theksohet se me qëllim të krijimit të stabilitetit financiar për OSSH-në, ZRRE gjatë shqyrtimit tarifor duhet të marr për bazë vlerën kohore të parasë, prandaj është shumë e rëndësishme që të reflektohen me kohë rritjet e pritshme.

Në tabelën e mëposhtme mund të gjeni saktë rritjet e nevojshme të tarifave për të reflektuar drejtë efektin e kostove kundrejtë të hyrave të pritshme. Tabela e mëposhtme supozon që rritja e pritshme e tarifave do të fillojë të aplikohet në muajin shkurt të vitit 2022 dhe do të vazhdojë përgjatë vitit.

Shitjet e pritshme	Total 2022
Te hyrat e pritshme	Total 2022
35 kv	1,622,692
10 kv	16,839,525
0.4 kv	282,892,502
Koeficienti i zbritjes vjetore	1%
<b>Total</b>	<b>287,587,664</b>
<b>MAR-i i pritshëm</b>	<b>Total 2022</b>
Dep	17,890,204
Return	16,712,386
Opex	25,690,471
Kostt	1,689,051
Përshtatjet	- 5,002,938
Humbjet e lejuara	225,351,642
Krev	18,194,898
<b>Total</b>	<b>300,525,714</b>
Koeficienti i zbritjes vjetore	1%
<b>Total</b>	<b>287,587,664</b>

Vonesat e mundshme në reflektimin e drejtë të tarifës së pritshme do të vazhdojë të rëndojë tutje stabilitetin financiar të OSSH-së, dhe përkatësisht mund të lind nevoja për shqyrtim të jashtëzakonshëm përsëri.